

**V E N D I M**  
**Nr.343, datë 29.5.2003**

**PËR BLERJE KARBURANTI PËR AUTOMJETE DHE PËR NGROHJE  
QENDRORE, NGA MINISTRITË, INSTITUCIONET QENDRORE, BUXHETORE DHE  
ENTET NË VARËSI TË TYRE, TË CILAT NUK I KANË PËRDORUR FONDET E  
PARASHIKUARA NË VENDIMIN NR.206, DATË 28.3.2003 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Ministrinë, institucionet qendrore, buxhetore dhe ato të varësisë, të cilat deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi nuk i kanë përdorur, tërësisht ose pjesërisht, fondet e parashikuara në vendimin nr.206, datë 28.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për blerje karburanti për automjete dhe për ngrohje qendrore nga ministrinë, institucionet qendrore, buxhetore dhe entet në varësi të tyre, me procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë””, t’i përdorin këto fonde, deri më 1 korrik 2003, me procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” si më poshtë vijon:

a) Me shoqërinë “ARMO” sh.a., Fier, për blerje gazoili (naftë) për furnizimin e automjeteve me tallona, kundrejt çmimit 65 lekë/litër dhe për blerje gazoili (naftë) për furnizimin e automjeteve dhe për ngrohje qendrore, me tërheqje me autobot, kundrejt çmimit 57 lekë/litër.

b) Me shoqëritë “Petrolimpex” sh.a., Tiranë, për blerje gazoili (naftë) importi, për furnizimin e automjeteve me tallona, kundrejt çmimit 80 lekë/litër dhe për blerje gazoili (naftë) importi për furnizimin e automjeteve dhe për ngrohje qendrore, me tërheqje me autobot, kundrejt çmimit 70 lekë/litër.

2. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet qendrore, buxhetore dhe ato të varësisë, si dhe shoqëritë anonime “Armo” dhe “Petrolimpex” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**